



Ndërmarrja Publike Qendrore

Posta e Kosovës Sh.A.

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Dreitorëve me rregullore për marrjen dhe dhënien me qira te objekteve, pronave dhe hapësirave të PK Sh A., Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar të hyra duke ofruar me qira hapësirat e lira nëpër objekte. Bazuar ne rregulloret e brendshme dhe Ligjet ne fuqi Posta së Kosoves Sh A., nxjerr këtë:

OFERTË PËR LËSHIMIN E HAPËSIRAVE ME QIRA

KUSHTET DHE KRITERET E PK SH.A. PËR LESHIMIN E HAPËSIRAVE ME QIRA

- Hapësirat të cilat janë ofertuar për qiradhënie gjenden në katin përdhes të objekteve. Qasja deri tek hapësira për qiradhënie (e cila ka hyrje të veçanët) apo do të bëhet përmes hyrjes kryesore dhe hapësirës së korridorit të përbashkët me PK Sh. A., (kjo hapësirë nuk është e përfshirë në qira).
- Të gjitha hapësirat për qiradhënie janë të njëjta si nga arkitektura, interieri dhe fasada e jashtme. Secili Objekt i lartë cekur për qiradhënie ndodhet në qendër të qytetit dhe me pamje nga rruga kryesore .
- Hapësira që do të lëshohet me qira, do të dorëzohet qiramarrësit sipas gjendjes ekzistuese.
- Qiramarrësi do ta këtë të drejtën që në hapësirën e marr me qira të beje përmirësime, meremetime dhe adaptime shtese, investime të cilat do të mbulohen nga vet qiramarrësi.
- Nëse qiramarrësi dëshiron të beje ndonjë përmirësim, meremetim apo adaptim të hapësirës së jashtme, ndryshimet nuk mund të jenë në disproporcion me pamjen e jashtme të objektit.
- Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës, ujit dhe shërbimeve të tjera komunale do të paguhen nga qiramarrësi konform përpjesëtimit të shfrytëzimit të objektit apo nëse ofrohen kushtet teknike të jone të ndara në orëmatës të veçantë.
- Qiramarrësi nuk do ta këtë të drejtën e vendosjes së reklamave me të mëdha se sa reklamat e Postes së Kosovës. Për formën dhe vendin e vendosjes së reklamave duhet të bëhet në pajtim me qiradhënësin.
- Të gjithë të interesuarit do ta kenë mundësinë që paraprakisht ti vizitojnë objektet dhe ti verifikojnë sipërfaqet e hapësirave.

Lista e objekteve dhe hapësirave për qiradhënie

Emërtimi i Objektivit	Adresa	Sipërfaqja (m2)	Kontakti	Vërejtje
Objekti i Postës në Besian	Rr. Zahir Pajaziti p.n	115	Jahir Gashi Tel.	Kati përdhes
Objekti i Postës në Lipjan	Rr.Adem Jashari pn.	115	Bislim Buja Tel.	Kati përdhes
Objekti i Postës në Fushë Kosovë	Fushë Kosovë	115		Kati përdhese
Objekti i Postës në Prizren	Rr. Adem Jashari pn.	43		Kati përdhes
Objekti i Postës në Suharekë	Brigada 123	115		Kati përdhes
Objekti i Postës në Dragash	Dragash	122		Kati përdhes
Objekti i Postës në Rahovec	Rr. "Xhelal Hajda Toni"	115		Kati përdhes
Objekti i Postës në Gjakovë	Rr."UÇK"	168		Kati përdhes
Objekti i Postës në Gjilan	28 Nëntori p.n	140		Kati përdhes
Objekti i Postës në Kamenicë	Kamenicë	115		Kati përdhes

Sqarim për llojin e veprimtarisë:

Ofertuesit të cilët nuk do të kualifikohen do të jenë ata të cilët ushtrojnë veprimtari të si më poshtë:

1. Te cilat ofrojnë shërbime konkurruese që i ofron Posta e Kosovës (shërbime postare, telekomunikuese, institucionet financiare jo bankare).
2. Ato veprimtari të cilat mund të jenë të dëmshme ose të cilat ndikojnë në imazhin e Postes së Kosovës (psh. Kasino, Bastore, qebaptore, byrektore si dhe veprimtari tjera që mund të ndikojnë në imazhin e PK Sh. A.),
3. Ato veprimtari e cila janë në kundërshtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës,

Kriteret:

1. Çmimet e caktuara në ofertë janë të negociuara.
2. Afati kohor i kontratës i negociuar, përparësi do të keni oferta me afatet më të gjata.
3. Si qiramarrës do të përzgjidhet ofertuesi që ofron vlerën më të madhe për m² për secilin objekt.
4. Një komisioni i themeluar nga PK Sh A, do të beje vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave më të mira dhe më të favorshme.
5. Afatet dhe kushtet e pagesës do të jenë konform negociatave të zhvilluara.

Dokumentet e nevojshme:

Personat fizikë të cilët marrin pjesë duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Një dokument identifikues (Letërnjoftim ,Pasaportë apo Patentë shofer Valid)
- Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur .

Personat Juridik të cilët marrin pjesë duhet të bashkangjesin këto dokumente :

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin,
- Numrin fiskal.
- Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur.

Afati për dorëzimin e ofertave:

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është deri me datën 15.11.2016 në ora 14:00,
- Vendi i dozimit, Dardania p.n. Arkiva e Postës së Kosovës Sh. A,